

# LULET E VERËSË

NAIM FRASHËRI

## JETA

- 1 Sa e dua gjithë jetën!
- 2 Se atje gjenj të vërtetën,
- 3 Yjtë, nënën, hapësirën,
- 4 Të mugëtit, natën, ditën,
- 5 Mëngjezë, djellinë, dritën,
- 6 Mbrëmën, dh'atë errësirën
  
- 7 Natën, kur është'e qetuar,
- 8 Edhe gjësendi s'dëgjonet;
- 9 Qjellin kur është'i qëruar,
- 10 E hapësira ndritonet,
- 11 Ret' e zeza sterrë nd'erë.
  
- 12 Vapën, vjeshtën, dimrin verën,
- 13 Retë, shinë, dhe lumenjtë,
- 14 Gjëmim, mjërgullë, përrenjtë,
- 15 Dborën, brëshërin'e erën,

- 16 Malet, fushat edhe brigjet,  
17 Grykat, çukat edhe shtigjet.
- 18 Oshëtimën, pyjet, drurët,  
19 Shkëmbenjtë, gërxhet'e gurtë.
- 20 Lulet, barërat që mbijnë,  
21 E shpesët që fluturojnë,  
22 Edhe këngëra këndojnë,  
23 E në për dega lëvrijnë.
- 24 Dhe njerin'e bagëtinë  
25 Dhe gjithë ç'është në jetë  
26 I dua si Perëndinë,  
27 Se nga do që këthenj sytë  
28 Shoh atje Zotn'e vërtetë  
29 Q'është një e s'ka të dytë.

### **KOH'E SHKUARË**

- 1 Kam pushuar, jam qetuar,  
2 E rri më nj'an'e derth lot,  
3 Me zemër të përvëluar,  
4 Me hulm me hidhërim plot.

5 Si zogu, kur bje e fryn  
6 Dheu mbushet me dëborë,  
7 Nën' strehët i mjeri hyn,  
8 Rri i varfër e i gJORë.

9 Sheh dëborënë që bje,  
10 Edhe zinë që ka rënë,  
11 Botën pa shij'e pa hije,  
12 Dhe s'guxon të nxier zënë.

13 S'sheh gjëkundi lul'e fletë  
14 Po të ngrit'e ftohtësire,  
15 Jetënë gjithë të qetë,  
16 Gjithësinë shkretëtirë.

17 Dhenë të bardhë si vezë,  
18 Dhe pa gjeth'e pa burbuqe,  
19 Zëmrëzën'e tij të zezë,  
20 Q'e pat si lule të kuqe.

21 Më s'sheh shok, as fis, as miq.  
22 As fëmijë, as folezë,

23 Shpresëza e tij i vdiq,  
24 E ju përhap posi rezë.

25 Pa kokëzën'e fut në gjit,  
26 Mbyll syt e hyn në mejtim,  
27 Mejtohet edhe psherëtit  
28 Me mall shumë'e mallëngjim.

29 Mos pandeh se fle, a dremit,  
30 Kur e sheh q'është qetuar,  
31 Dhe këllet kokëzën në gjit,  
32 Është gjithënjë i xgjuar.

33 Me mëndjezët të tij thotë,  
34 Ah! shkoj, vate, koh' e mirë,  
35 Dua e mundohem kotë,  
36 S'e kthej dot me të pahirë.

37 ju drurët'e uruar!  
38 Ju shoh pa lul'e pa fletë,  
39 Të rjepur të varfëruar,  
40 Edhe të that'e të shkretë!

41 Kështu si ju edhe unë  
42 Ndë jetë të shkret u thashë,  
43 O! sa fletë m'u-këpunë,  
44 Edhe ran'e më s' i pashë!

45 Edhe ju fusha e male  
46 Që nukë prishi e s'ndrohi,  
47 Edhe ju dale nga dale  
48 Më duketë po ndryshojti!

49 Ah! dhe ju ishit të tjerë,  
50 Yjt' e bukur, e ti hënë  
51 Kur u shikonja një herë  
52 Tani një zi u ka rënë.

53 Moj kohëz' e djalërisë  
54 Sa me vrap ike dhe shkove,  
55 Hyre në gjit të Perëndisë  
56 Edhe mua më harove.

57 Ti çdo gjëzë m'a tregove  
58 Të bukur e fort të mirë,  
59 Edhe gazë m'a shumove

60 E m'epnje shumë dëshirë.  
61 Si t'ja bënjë zemr'e mjerë,  
62 Me kohën gënjeshtare  
63 Që ndrohetë kurdoherë,  
64 Dhe s'ngjan ime të parët fare!  
  
65 Duke ikur na rrëmben,  
66 Gjithë ç'duam e ç'gjë kemi,  
67 Ah! e shkreta ç'na gënjen,  
68 Ashtu si qemë më s'jemi!  
  
69 Le të bëhet urdhëri yt,  
70 Zot' i math e i vërtetë!  
71 Po pse të na mbetet në syt  
72 Kjo koh'e shkuar e shkretë?

### **DIT'E RE**

1 Sot është një dit'e rëzë që përsëritet moti,  
2 Lint vera, lint ngrohtësija, lint Aliu vetë Zoti.  
3 Është një dit'e bekuar, që rrjedh qiejshit bukurija,  
4 Del në sheshi Zot'i vërtetë, rrëfen fytyrën e tija.

5 Ngjallen të vdekurit gjithë, mal'e fusha gjelbërojnë,  
6 Qielli qesh, dheu gëzohet, dhe lulet lulëzojnë.  
7 Thonë dimëri na prishi, po s'na humbi dot për jetë,  
8 Erdhi kjo dit'e na gjeti, nuk'e la dhenë të shkretë.  
9 Qielli është ndrituar edhe bërë si pasqyrë,  
10 Dheu është zbukuruar, bërë fytyrë fytyrë.  
11 Veshur në bar e në lule edhe në gjethe në fletë,  
12 Bukuri e Perëndisë ka dal'e duket në jetë.  
13 Ujërat po burojnë, dhe venë duke kënduar,  
14 S'shoh gjësendi të pëlyrur, gjithë janë lar e nduar.  
15 Shqerratë po blegërijnë, edhe mëmate kërkojnë,  
16 Zoqtë nër gjethe lëvrijnë, dhe këndojn'e fluturojnë.  
17 Gjithë ç'janë ngjallen, çelen, përsëriten, zbukurohen,  
18 Duhet, qeshin, rrojnë, prehen edhe këndojn'e gëzohen.  
19 Lint Aliu, çfaqet dita, del Zoti, vjen e vërteta,  
20 Mbleron dheut ëmbëlsira, edhe rojit po si bleta.  
21 Në këtë gosti të Zotit gjithë bota janë ftuar,  
22 Të bëhen një shpirt një trup e të jenë të pajtuar.  
23 Është dit'e dashurisë, ditë e vëllazërisë,  
24 Dit'e mbarë e gëzimit, dit'e bardhë e miqësisë.  
25 njeri! paskëtaj kurrë fjalë të ligë mos thuash,  
26 Po përshëndosh gjithë ç'janë, thuaj gëzuash! gëzuash!

## PËR SE?

- 1 Pse s' vjen, o dit' e mirë,
- 2 Pse vallë nukë vjen?
- 3 Gjer kur në errësirë?
- 4 Mos Zoti të pëlqen?
  
- 5 As hidhe gardhe,
- 6 Dhe shpejto pakë,
- 7 dit' e bardhë,
- 8 Dhe jakë, jakë,
  
- 9 Se të pres,
- 10 Nukë vdes.
  
- 11 Jak' o dit' e uruar!
- 12 Që lind nga perëndon,
- 13 At' an' e ke ndrituar
- 14 E ne pse na haron?
  
- 15 Dritëz' e jetës!
- 16 Edhe e motit
- 17 Dhe e së vërtetës,



18 Dhe gaz'i Zotit,

19 Ndritëna

20 E xgjohna.

## ZËMËRA

1 Fuqi' e Perëndisë

2 Duketë tek do,

3 Se shpirt'i gjithësisë

4 Po është ajo.

5 Ajo është gjithë ç'janë,

6 Është në çdo vënt

7 E duket më ç'do anë,

8 Në trup e në mënt.

9 E shohëmë në qiej,

10 Në shi e në rë,

11 Ndë hen'e në për diej

12 Ësht' edhe në dhë.

13 Më tepër zemrën tënë

- 14 Atë ka për fron,  
15 Nuk ja dëgjon zënë,  
16 Zemrën s'e dëgjon?

### **DIT'E ZEZË**

- 1 U gdhi një ditë, një dit'e zezë,  
2 Engjëllit' gjithë me lot po qanin,  
3 Përpara Zotit shihnin një rezë,  
4 Rrinin tmeruar edhe zi mbanin.
- 5 Dheu qe mbuluar ane një errësirë,  
6 E tërë bota ish egërsuar,  
7 Dielli e hëna ishin nxirë,  
8 Qielli ishte i trubulluar.
- 9 Ish bërë sterrë tej-për-tej jeta,  
10 E ishte një tmer, tmer i mërzitur,  
11 Se kishte humbur gjith'e vërteta,  
12 Se gjithë bota isht'e mahnitur!
- 13 Paudhësija dhe ligësija  
14 Ishte bërë mbret mbi det të shkretë!

15 Dhe të këqijat e padija  
16 Kishin zënë vënt për të vërtetë!  
  
17 Ish një mynxyrë mbi njerëzinë!  
18 Sepse gënj eshtra po prist'e qepte,  
19 E kish verbuar fare njerinë,  
20 Edh' e vërteta po mirt'e jepte.  
  
21 Dritëz'e bukur e Perëndisë  
22 Nd'anët e rripës kishte qëndruar,  
23 Dhe errësira e ligësisë  
24 Nga të gjith'anët e kish rrethuar.  
  
25 Lufton gënjeshtër me të vërtetën,  
26 Dhe errësira dritën luftonte,  
27 Që t'errsonte së gjithash jetën,  
28 Dhe djallëzija të mbretëronte.  
  
29 Po derdhej gjaku, gjak i bekuar,  
30 Qjelli kish hedhur cipën e zisë.  
31 Përpara syve të Perëndisë,  
32 Ëngjëjtë qanin duk'e tmeruar.

- 33 Yj edhe qiej! qysh s'u-rrëzuatë?  
34 E si s'u bëtë cop'e thërime?  
35 Diell e Hënë për se qëndruatë?  
36 E nuk'u bëtë si zëmra ime?
- 37 Zot i jetës, shumë durove,  
38 Shumë durove, o zëmër-gjërë,  
39 Po na të gJORËT na përvëllove,  
40 Na perzëllite zemrën e mjerë!
- 41 Njeri i ndyrë, komb'i mërziTUR!  
42 Imam Hysenit i heth shëGJETË?  
43 Nukë di se ç'bën, je i mahNITUR?  
44 E kë godit kshu? Zotn'e vëRTETË?

### **BESOJMË**

- 1 Besojmë Zotnë q'është' i vërtetë,  
2 Se gjithë ç'shahem është' ay vetë,  
3 Dhe falëtore kemi njerinë,  
4 Atje e gjejmë dhe Perëndinë.  
5 Ëngjellë thuhetë vetij'e mirë,  
6 Dhe djalli ështëë pun'e pështirë.

7 Njeriu s'vdes' po vetëm ndërrohet,  
8 Dhe shpirt i ndyrë kurrë s'gëzohet.  
9 Njerin'e bëri Zoti të lirë,  
10 Po duhet kurdo të bënjë mirë,  
11 Dhe i dha mëndjen që të peshonjë.  
12 Dhe të paudhat t'i largësojnë.  
13 Të mos përflasë, të mos qërtonja,  
14 Të jet'i urtë, me nder të rronjë,  
15 Shpirti na thotë të bëjmë mirë,  
16 E të rnos kemi kurrë dëshirë,  
17 Për të këqia kurrë në jetë,  
18 Të jemi t'urtë e të vërtetë.  
19 Fort lark të jemi nga marrëzija,  
20 E të mos rrojmë si bagëtija.  
21 Falje ne kemi vëllazërinë  
22 Dha dashurinë e njerëzinë,  
23 Se udh' e drejtë e Perëndisë,  
24 Nuk' është tjetër, veç njerëzisë.  
25 Po të nderojë njeriu njerinë,  
26 E ka nderuar dhe Perëndinë  
27 Në zëmrët tënë e gjejmë Zonë,  
28 Shtëpi e tij është zëmra jonë.  
29 Të dil në shesh desh Zot'i vërtetë,

- 30 Bëri njerinë dhe atje është vetë.  
31 Një njeri që njeh vethen e tija,  
32 E di se ç'është dhe Perëndija.

### **UJËT E BEKUARË**

- 1 Ejani këtu, o shokë,  
2 Mblidhuni kokë për kokë,  
3 Pini të bëhem trakë,  
4 Të na shohë Perëndija!
- 5 Këtej e tutje s'gënjem,  
6 Me të rreme më s'rrembehem.  
7 Dua të pi e të dehem,  
8 Ku është vera dhe rakija?
- 9 ujthit'e bekuar!  
10 Nga qjelli na ke buruar?  
11 Zot'i math të ka dërguar  
12 Që të çelçë zemrën tënë?
- 13 Lule mbijn' tek pikon tinë,  
14 Ti na bje batbardhësinë

15 Edhe gashin'e gaxhinë,  
16 Haps'i tyre t'është dhënë.

17 Ti neve na e bje nderë,  
18 Nga mendimet duke nxjerë,  
19 Na fluturon nëpër erë,  
20 E na pjek me Perëndinë!

21 Gjithë ç'janë na mundojnë,  
22 Shpirtin na e përvëlojnë,  
23 Na tretin e na kullojnë,  
24 Vetëm ti e do njerinë.

25 Dashurinë duke mbjellë,  
26 Dhe këngëtë duke pjellë,  
27 E gas të math duke sjellë,  
28 Mjerësija na mbulohet.

29 Të këqijatë harrohen.  
30 Dhe mejtimetë s'mbarohen.  
31 Edhe brengatë s'mejtohen,  
32 Njeriu qesh e gëzohet.

33     Jakën! shokë, të rrimë,  
34     Rreth druvezes' e të pimë,  
35     Se të nesërmen s' e dimë,  
36     Na arriti pleqërija.

37     Koha po shkon e më s'kthehet,  
38     Njeriu i zi gënjehet,  
39     Me punë të rrema merret,  
40     Dhe e mbulon babëzija!

41     Gjithë jetën nukë rrojmë,  
42     Shpirtinë pse t' e mendojmë?  
43     Pa qasuni të këndojmë,  
44     Se na plasi buz' e shkretë.

45     Shkel e shko zëmëra ime.  
46     Mos bjerë në hidhërimë,  
47     E në breng' e në mejtime,  
48     Mos të gënjenjë kjo jetë.

## **PËRPARA KRISHTITË**

1     Djalëth njeriu i Perëndisë



2 Fytyra jote mua më tregon  
3 Ah! të këqijat'e njerëzisë,  
4 Që ka punuar edhe punon.

5 Se kjo fytyrë  
6 Është pasqyrë,  
7 Dhe na rrëfen,  
8 E s'na gënjen.

9 Gjithë ç'ka hequr njeriu i mjerë  
10 Nga veth'e tinë a nga i vëllaj  
11 Që kanë vrarë e kanë prerë  
12 Pa gjyq, pa fjalë, pa pasurë faj.

13 Zot, ti ke vuar  
14 Edhe s'ike pushuar,  
15 Nga njeriu hoqe,  
16 Për të u përpoqe.

17 Ti u përpoqe për njerëzinë,  
18 Dhe dashurinë e bëre besë,  
19 Njeriut vure nam miqësinë.  
20 Që kur të lindet gjer sa të vdesë.

- 21 Për këtë fjalë  
22 Të qofsha falë,  
23 Se njerëzija  
24 Ë Perëndija.

### ZONJ'E FATIT

- 1 moj plaka lozonjare,  
2 Që ndjek fatn'e njerëzisë,  
3 Dhe mas'e pesh s'ke fare,  
4 Po me shkop të marrëzisë.
- 5 Moj, po me ç'sy e me ç'faqe  
6 Më qasesh prap'e më çfaqë?
- 7 Të shoh që vjen po si hie  
8 Niga dale, si qen i qetë  
9 Edhe hi syvet më shtie  
10 T'u thaft' ajo dor' e shkretë!
- 11 Ata sy të zgurdulluar  
12 T'i shoh, o e mallëkuari

13 S'je e verbërë si thonë,  
14 Që s'sheh, s'di se ç'bën në jetë;  
15 S'je e shurdhër, pasha Zonë!  
16 Dëgjon posi djalli vetë,

17 Po je e keqe dhe shtrigë,  
18 E pahes'e zëmër ligë!

19 Ti fjalëtë i ke kthyer,  
20 Pandaj na ke përvëluar,  
21 A! popo! ç'na ke gënjyer!  
22 Njeri s'të ka trashëguar.

23 Dhe kur ndrin, ndrin si lugati,  
24 Pandaj s'të ka qëndrim fati.

25 Jakë, se jam dëshëruar,  
26 E më s'e duroj dot vrerë,  
27 Qesh, mos rri e zemëruar,  
28 Makar për një copë herë.

29 Qesh një herë, o leshra krënde,

30 Me të qarë nuk' u dënde?

**ABAZ — ALIU**

1 Engjëll! që m' u qasë pranë

2 Nga i madhi Zot,

3 Pse më rrëfen Qerbelanë?

4 A do të derth lot?

5 moj fush'e Qerbelasë!

6 Që më rri ndër sy,

7 Plot me gjak t' Ali-Abasë,

8 Vallë ç' është' ay?

9 Ç' është' ay që shkon kaluar,

10 Ikën si veriu,

11 Me dy-tri foshnja nër duar?

12 Është' Abas-Aliu!

13 Shpije foshnjatë në lumë,

14 Se s' durojnë dot,

15 I ka marrë etja shumë,

16 E qajnë me lot!

17 Ujët ua kanë prerë  
18 Janë në shtrëngim,  
19 Si të varfër e të mjerë.  
20 Në zi, në hidhërim.

21 Më ç' do an' i ka rrethuar  
22 Kombi faqezi,  
23 Komb'i lik i xnallëkuar,  
24 Posi mizëri!

25 Nëpër mest të ushtrisë  
26 Të armikut shkon,  
27 Si ëngjëll i Perëndisë,  
28 Nd'erë fluturoni

29 Shigjetat si breshërimë  
30 I vinë ngado,  
31 Ay po si vetëtimë  
32 Ikën nëpër 'to.

33 Shërbtor'e njerëzisë  
34 Shigjeta s'e çpon

35 Edhe nder'e trimërisë  
36 Zoti e mburon.  
  
37 Ç'ikën ay kal'i shkretë,  
38 Mi dhë nuk shkel  
39 Nga potkonjtë q'ikën shpejtë  
40 Zjar e flak'i del!  
  
41 moj kafshëz e uruar,  
42 Mos shkel për mi dhë.  
43 Se'shtë gjaku i bekuar,  
44 Ikë nëpër rë!  
  
45 Frat, o more lum'i shkreti  
46 Mos këndo pa qaj,  
47 Derth lot e rënko për jetë,  
48 Mos qesh paskëtaj;  
  
49 Se Hysejn'e Fatimesë  
50 Me faret të ti,  
51 E vranë komb'i pabesë,  
52 Kombi faqezi.

53 Abas Aliu zu' Tomorë,  
54 Erdhi afër nesh,  
55 Shqipëria s'mbet e gjorë,  
56 Se Zoti e desh.

57 Hysejni desh njerëzinë,  
58 Dhe për të u vra,  
59 Për të shpëtuar njerinë  
60 Ra nde Qerbela.

61 Hysejni 'shtë dashurija  
62 Që fatbardhëson,  
63 Buron soje miqësija,  
64 Qe na lartëson.

65 Jeziti 'shtë egërsirë,  
66 Që sjell ligësi,  
67 Dhe s'del soje pun'e mirë  
68 Po dëm edhe zi.

69 Kushdo që bën mirësinë  
70 E ka njerëzi  
71 Ka besuar Alinë,

- 72 Dhe udhën e ti.
- 73 Gënjeshtër 'shtë Mavijeja,  
74 Që prish edhe sot,  
75 E drejta 'shtë Fatimja,  
76 Dhe i madhi Zot.
- 77 E liga është Mervani  
78 Që nxin e shkretën,  
79 Djallëzija 'shtë Syf jani,  
80 Që dhe sot dërmon.
- 81 Imamëtë dymbëdhjetë  
82 Nga der'e Aliut,  
83 Hoqn'e vuanë ndë jetë  
84 Por nder të njeriut.
- 85 Zotërinj! ju qofsha falë!  
86 Që hoqtë për ne,  
87 Na latë vetëm një fjalë  
88 Për bes'e fe.

**FYELLI**



1 Pa dëgjo fyellin ç' thotë  
2 Tregon mërgimet e shkreta,  
3 Qahet nga e zeza botë  
4 Me fjalë të vërteta.

5 Që kur se më kanë ndarë  
6 Nga shok' e nga miqësija,  
7 Gra e burra kanë qarë  
8 Nga ngashërimet e mija!

9 Krahërore e kam çpuar  
10 E kam bërë vrima vrima,  
11 Dhe kam qar' e kam rënkuar  
12 Me mijëra psherëtima!

13 Dhe me botën e gëzuar  
14 Bëhem shok edhe marr pjesë,  
15 Dhe me njerës të helmuar  
16 Bënem mik me besa-besë.

17 Puna si do që të bjerë  
18 Unë qanj me mallëngjime,

19 Më çdo vënt e kur-do-herë  
20 Psherëtin zëmëra ime!

21 Gjithë bota më dëgjojnë  
22 Po së jashtëmi më shohin,  
23 Dëshirën s'm'a kupëtojnë  
24 Zjar' e brendëshme s'm'a njohim.

25 Njerëzit me mua rrinë,  
26 Unë qanj' e mallëngjehem,  
27 Po dufn' e pshehtë s'm'a dinë  
28 Andaj kurrë s'përdëllehem.

29 Gjith' ata që janë ndarë  
30 Fyellit shokë ju bënë,  
31 Shkallët' e tij disa farë,  
32 Na shkalluan mëndjen tënë.

33 rrëmet i njerëzisë!  
34 Zër' i fyellit s'është' erë,  
35 Ky është' zjarr' i dashurisë  
36 Që i ra kallamit mjerë!

37 I ra qiellit e ndriti,  
38 I ra zëmrësë e nxehu,  
39 I ra verës e buçiti,  
40 I ra shpirtit, dhe e dehu.

41 I dha erë trëndafilin  
42 I dha dritë bukurisë,  
43 I dha këngëtë bilbilit,  
44 I dha shije gjithësisë.

45 Ay zjar i ra në qiej,  
46 Edhe duke përvëluar,  
47 U bënë kaq yj e diej,  
48 Që i mba Zoti ndër duar,

49 Nga ky zjar Zot' i vërtetë,  
50 Që ka ngehur gjithësinë,  
51 Hoth një shkëndijë në jetë,  
52 Dhe bëri soje njerinë.

53 more zjar i bekuar!  
54 Unë me ty jam përzjerë,  
55 Pa jam tretur e kulluar,

56 Po të kam shpirt, mos më lerë.

### ZËMËRA

1 Retë kur bënenë sterrë  
2 Edhe era kërcëllimë,  
3 Dheu bënetë skëterrë  
4 Edhe qjelli vetëtimë.

5 Zë një shi me rrëmbim shumë,  
6 Që zbret nga ret' e mbyt dhenë,  
7 Bje qiejshit si lumë,  
8 Pa vete të gjejë denë.

9 Vinë përrenj t'e rrëketë,  
10 Edhe uj' i trubulluar  
11 Vë përpara ç'gjë të jetë,  
12 E ç'gjen mb' udhë duke shkuar.

13 Ashtu dhe zëmëra ime  
14 Nxjerr gjënim' e vetëtima,  
15 Zjar e flak' e mallëngjime,  
16 Derth gjaknë me psherëtima.

17 N'avull ngrihetë përpjetë  
18 Prej zëmërsë ngaha zjari,  
19 Edhe lotët si rrëketë  
20 Derdhenë syvet së qari!

21 miz' e mbyturë nd' ujë!  
22 Djell' i shpresësë në daltë,  
23 Do pushonjë kjo rrëmujë,  
24 e nukë mbetesh në balte.

25 Shiu bje, dheu gjelbërohet,  
26 Dhe vera vjen e gjen varrë,  
27 Varri me fletë mbulohet  
28 Dhe rrëkeja shkon t' a marrë!

29 det i thell' e pa anë!  
30 Që ke mbrenda gjithësinë,  
31 Nga ty dalin gjith c'janë,  
32 Edhe prapë tek ty vinë.

33 Gjer sa të vinj' e të bjerë  
34 Pik' e shpirtit t'im si lumi,

- 35 Në det të math e të gjerë  
36 Zemrën t'ime s'e ze gjumi.

### **TË VDEKURITË**

- 1 Jakë, mejtim, jakë,  
2 Dua të mejtohem,  
3 Të rri të qetohem,  
4 Edhe të qanj pakë.
- 5 moj koh' e shkuar,  
6 Kurdo që të kujtonj,  
7 Përsëri e lëndonj,  
8 Zemrën e lënduar.
- 9 Vallë ku na vanë,  
10 Gjithë ata shokë,  
11 Q'i patëm mi kokë  
12 Ku jan', ah! ku janë?
- 13 Qysh humpnë për jetë,  
14 Edhe më s'i pamë?  
15 Ah! me 'ta pse s'vamë

16 Na lanë të shkretë!  
17 Kur ishin të gjallë,  
18 Sa shumë i donim,  
19 Me një shpresë rronim!  
20 Si të mundim vallë?  
21 Pa qysh t'i harrojmë?  
22 Zëmra s'na duron  
23 Shpirti ndaj kërkon,  
24 Pa 'ta si të rrojmë?  
25 Të gjith' një qemë,  
26 E një zëmër kishim,  
27 Gjithë në shpirt ishim,  
28 Neve pas pse mbemë?  
29 Të shumë' u ndanë,  
30 Po vallë ku vanë?  
31 Për jet' u mërguan?  
32 A po u ndryshuan?  
33 Ndër sy po më rrinë!

34 Ah! sikundër qenë,  
35 Më vjen sikur flenë,  
36 Pandeh se do vinë.

37 I kam ndër mënt dhe sot  
38 Me shtat, me fytyrë,  
39 E zeza mynxyrë!  
40 Të arthtë keq, o Zot!

41 Më vjen shumë herë  
42 Sikundër do të vinë,  
43 Të gjejnë shtëpinë  
44 Ata dhe një herë.

45 Të na përqafojnë,  
46 E diç të na thonë,  
47 Si kishim zakone,  
48 Dhe me ne të rrojnë!

49 Po kur më kujtohet,  
50 Që janë të vdekur,  
51 Në dhet janë tretur,  
52 Zëmra më tmerohet.



53 I kemi mbuluar,  
54 Ah! në dhet të shkretë,  
55 Njeriu në jetë  
56 Lintka për të vuar!

57 Lint me ngasherime,  
58 Rron me hidhërimë,  
59 Heq shumë mundime,  
60 Vdes me psherëtime,

61 Dhe gjer sa të vdesë,  
62 Rrihet e përpiqet,  
63 Kurrë nuk' i hiqet  
64 Dhe e shkreta shpresë.

65 Zëmra na 'është vvarë,  
66 Dy copa 'shtë bërë  
67 S'e kemi të tërë,  
68 Se dy është çarë.

69 Një copë ka shkuar  
70 Dhe ka zënë varrë,

71 Ng' ata është ndarë,  
72 Ndë dhë 'shtë mbuluar,  
  
73 Zot i vërtetë!  
74 Me sa hidhërimë  
75 E me ç'mallëngjime  
76 Rron njeriu n'jetë!  
  
77 Të dashurit tanë  
78 Dheut krahët shtruan!  
79 Na e përvëluan  
80 Zemrën, na e ndanë.  
  
81 I kemi mbuluar  
82 Po shpirti që s'vdes,  
83 S'ka mbrëm' e mëngjes,  
84 Ku ka fluturuar?  
  
85 Se vdekja s'e zë dot,  
86 Po ku vallë qëndroj?  
87 Në burimt të tij shkoj,  
88 A, tek i madhi Zot?

89 Si lumi që këlthet  
90 Me shumë oshëtimë  
91 E me ulërimë  
92 Vete prapë në det.

93 Munt të na bashkojnë  
94 Krahëthit' e vdekjes,  
95 Ku 'shtë vënd' i pjekjes,  
96 Ndër 'ta të na çojnë.

97 Këtu duhet besa,  
98 Mendje pa pusho,  
99 Se zëmra m'a do,  
100 Dhe s'më pritet shpresa.

101 Kush dha hidhërimnë,  
102 Na dhuroj dhe besën,  
103 E të kemi shpresën,  
104 Kur heqim mundimnë.

105 U kam shumë mallë,  
106 Këtu më s'i shoh dot,  
107 Shpreh nek i madhi Zot,

108 Do t'i gjenj të gjallë.

109 Vdekja po na thërret!

110 Sado të mënojmë,

111 Varr' i ftohtë na pret,

112 Atje do të shkojmë!

113 Si lum ajy që rron

114 Njeri i vërtetë

115 Në jetë të shkretë,

116 E shpirtin s'e helmon.

117 Pa lulet q'u-thanë,

118 E nuk' i shohëm sot,

119 Vinë prapë mot,

120 Shpirtin gjali' e kanë.

## **BILBILI**

1 Hëna plot pesë-mbëdhjetë.

2 N'anët të qjellit po ndrin,

3 Bota është gjith' e qetë,

4 Gjësendi nuk' pipërin.

5 Qielli është' i qëruar,  
6 I kulluar po si ari,  
7 I fjetur e i qetuar,  
8 Syri s'nginjetë së pari.

9 Ka rrjedhurë si uj' ergjëndi  
10 Më të gjith' anët një dritë,  
11 Dhe prej soje gjithë vëndi  
12 Është bërë posi ditë.

13 Buruar një uj' i artë,  
14 E dhen' e ka xbukuruar,  
15 Majat' e malit të lartë  
16 Dhe gërxfhet i ka zbardhuar!

17 Mi brigj' e mi shesh' e drurë,  
18 Dhe përmi det drita bije,  
19 E mi shkëmbënj e mi gurë.  
20 Dhe vise që jan' në hije.

21 Nata është fort e qetë,  
22 Dhe gjith' i ka zënë gjumi,

23 Vetëm përrenj t'ë rrëketë  
24 Ligjerojnë, edhe lumi,  
  
25 Që oshëtin duke shkuar,  
26 Nxjer një zë plot ëmbëlsirë,  
27 Dhe ikën duke kënduar,  
28 Sa vete bukur' e mirë.  
  
29 Veriu fryn pakë nga dale,  
30 Njerës, kafshë, shpes' e fletë,  
31 Pyje, shkëmbinj, fusha, male,  
32 Të gjithë janë të qetë.  
  
33 Maji ka sjellë nga Zoti,  
34 Shumë bekim e urata,  
35 Është xbukuruar moti,  
36 Dhe n'ar' është veshur nata.  
  
37 Lulet kanë lulëzuar,  
38 Vjen një erë fort' e mirë,  
39 Drurëtë janë ngarkuar,  
40 Dhe barratë kanë mbirë.

41 Dhitë, kecërit e dhëntë  
42 Edhe shqerat jan' tulitur,  
43 Rrinë zgjuar vetëm qëntë,  
44 Nëpër ledhe janë shtritur.

45 Se nga dëgjonet thëllëza  
46 Që thotë tri katër fjalë,  
47 Nëpër brinj' e nëpër rrëza,  
48 Dhe deti ka pakë valë.

49 Një zë tjetër tani dëgjonj!  
50 Që zëmrënë m'a përvëlon!  
51 U-dogçë, më s'munt të duronj!  
52 Bilbili ka zën' e këndon!

53 Qiej, yj e dhë, pushoni,  
54 Tani juve kush u dëgjon,  
55 Vini veshn' edhe dëgjoni,  
56 Bilbili, bilbili këndon.

57 bilbil! e di se ç' dua,  
58 Andaj zëri i bukur yt,  
59 M'a dogji shpirtinë mua,

60 Edhe gjumë s'më hyn në syt!

### **NJË LUL' E VISHKURË, A NJË VASHËZ' E VDEKURË**

- 1 Pse mba mëri? s'e mar dot vesh,
- 2 Përse s'më flet si një herë?
- 3 Pse s'më shikon? pse nukë qesh?
- 4 Ç' rri kok' unjur dhe e mjerë!
  
- 5 Sa e qeshur më qe dije!
- 6 Të xbardhte gusha si kartë;
- 7 Buza me gas ç'të kish hie!
- 8 Më ishnje si fill' artë!
  
- 9 Popo! si më je shëmtuar!
- 10 Të ka zënë varfërija,
- 11 Më je tretur e kulluar!
- 12 Ku fluturoj bukurija?
  
- 13 Të shoh të fishkurë për dhë,
- 14 pa shpirt, pa gjak, pa fytyrë,
- 15 Na le, o lulezë, na le!
- 16 vdekje! ç'je një mynxyrë!!



17 Që lott' e syvet s'i shikon,  
18 S'vë vesh në mallëngjime,  
19 Je e shurdhër, nukë dëgjon,  
20 Ah! je plot me hidhërimë!

21 Sa na dhemp e shkreta jetë!  
22 Ndonëse nuk' e pëlqejmë,  
23 E pandehini të vërtetë,  
24 Me gjësendi s'e çkëmbejmë!

25 Të korr' o lulez' e gjorë,  
26 Të hedhë në jetet tjetër,  
27 E nga neve hoqe dorë!  
28 Më s'na ke t'ënt' as të afër!

29 Ah! dh' ata që kanë shkuar,  
30 Zëmërnë zhur na e bënë,  
31 E kemi të përvëluar,  
32 Zëmra prej guri s'ka qënë.

33 Paskëtaj buza më s'më qesh,  
34 Se zëmra m'është' e lënduar,

35     Zot' i vërtetë! të më ndjesh,  
36     Jam djegur e përvëluar.

37     Qiej! veshuni në të zi!  
38     Edhe ju yj më mos ndrini!  
39     hënë, mos del përsëri!  
40     Gjithë të helmuar rrini.

41     Nxihu, o diell' i shkretë!  
42     Ditë, rrobën' e natës hidh!  
43     Thahu e ti po dhë për jetë,  
44     Ti lumë, qetohu, mos klith.

45     Të mbarohetë kjo jetë!  
46     Të mbretëronjë pushimi!  
47     Të bijemë në të qetë!  
48     Të gjenjë funt hidhërimi!

49     Rrojmë këtu me mundime.  
50     Me ah, e me psherëtima,  
51     Me breng' e me mallëngjime.  
52     Me vaj e me ngashërима.

53 Më së fundi hyjmë në dhet,  
54 Edhe kurrë më s'na gjejnë!  
55 Bijem e humbasëm në det,  
56 Dhe valëtë na rrëmbejnë!

57 Të rrëmbyen edhe tynë,  
58 lulez' e bukurisë!  
59 T'a sheh të venitur synë,  
60 Më ke fytyrën' e zisë!

61 Kur dhë shpirtinë ti pshonje,  
62 Me një psherëtimë si zjari,  
63 Gjithë ç'jan' i përvëlonje  
64 Nukë mbetej as një fill bari.

65 Vallë ku do të të shpijen,  
66 Në qiej, përpara Zotit?  
67 A kërkojnë të të shtijen  
68 Prapë në duart të motit?

69 Të linç për të vdekur prapë,  
70 E të vdeç, që prapë të linç,  
71 Edhe kështu vër' e vapë,

- 72 Gjithënjë të veç' e të vinç?  
73 A po për jetë do të shkosh,  
74 Mosqënja të të mbulonjë,  
75 Edhe ti jetën fa harosh,  
76 Dh' ajo ty të haronjë?

### **GJUHA JONË**

- 1 Vëllezër Shqipëtarë!  
2 Të prekim urtësinë,  
3 Të zëm' udhën' e mbarë,  
4 Të ngjallim Shqipërinë.  
  
5 Shqipërija ka qënë,  
6 Edhe po do të jetë,  
7 Po sot në ditët tënë  
8 Të metë të mos ketë.  
  
9 E ka nderuar Zoti  
10 Gjithënjë Shqipërinë,  
11 Ish fort mirë qëmoti,  
12 Do bëhet dhe taninë.

13 Sa ishte trimërija  
14 N'atë kohët të vjetrë,  
15 Kish emrë Shqipërija,  
16 Sa s'kish nonjë vënt tjetër.

17 Sa burra kordhëtarë  
18 Ka nxjerrë Shqipërija,  
19 Më pastaj e më parë  
20 Q'i shkruan Istorija.

21 Ajo ish koh' e zjartë,  
22 Dhe kish mundime tepër,  
23 Po sot pendë dhe kartë  
24 Na duhet, nukë tjetër.

25 burra Shqipëtarë,  
26 Të marim dituritë,  
27 Se s'është koh' e parë,  
28 Tani lipsetë dritë.

29 Të shkruajm gjuhën tënë,  
30 Kombinë t'a ndritojmë,

31 Gjithë ç'është' e ç'ka qënë

32 Nga dalëzë t'a msojmë.

33 Pa shihni ç'gjuh' e mirë!

34 Sa shije ka e hije,

35 Ç'e bukur' edh' e lirë,

36 Si gjuhë Perëndije!

37 Shum' e bardhë kjo ditë

38 Për gjithë Shqipëtarët,

39 Do na sjellë një dritë,

40 Që s'e kishin të parët.

41 Kjo dritë do na bjerë

42 Të gjitha mirësitë,

43 Dhe gjithë dot' i ngrerë

44 Dëmet' e marrëzitetë.

45 Si lum kush zë të mbjellë!

46 Lum kush vë bëtë pemë!

47 Se kjo ka për të pjellë,

48 S'mbulohetë me remë.

## KORÇA

- 1 vëllezër Shqipëtarë!
- 2 Gëzohi! që erdh kjo ditë,
- 3 Kaq' e mir' e kaq' e mbarë,
- 4 Që sjell gjithë mirësitë.
  
- 5 Kjo është dit' e rrezë,
- 6 Që bije vëllazërinë,
- 7 E dëbon jetën e zezë,
- 8 Dhe ndarjen' e marrëzinë.
  
- 9 T'a lusimë këtë ditë
- 10 Që bekoj Zot' i vërtetë,
- 11 Dh' e dërgoj me shumë dritë.
- 12 T'i mbes emëri për jetë.
  
- 13 Sot e vumë gurr' e parë.
- 14 E bekuar është' kjo ditë,
- 15 Zot' i madh e pruftë mbarë,
- 16 E na dhëntë urtësitë!
  
- 17 Hapu, Lapu errësirë!

18 Pa jakë tëhu o dritë!  
19 Se arriti koh' e mirë,  
20 U gdhi nata u bë ditë.

21 Sot niset një tjetër jetë,  
22 Të rremenë posht' e shtije,  
23 Mbretëron fjal' e vërtetë  
24 Dhe të mirat gjith' i bije.

25 Zot' i math qoft' i lëvduar!  
26 Q'e nxjer në shesh të vërtetën,  
27 Se ajo sij ka buruar,  
28 Pa e ka ndituar jetën.

29 Lumja ti, moj Korç' o lule,  
30 Q'i le pas shoqet e tua,  
31 Si trimi në ball' u sulë,  
32 T'a paçim për jetë hua.

33 Kushdo që është sot burrë,  
34 Dhe Shqipëtar i vërtetë,  
35 Emëri s'i shuhet kurrë,  
36 Dhe nderi i rron për jetë.



37 Gjuha jonë sa e mirë!  
38 Sa e ëmbël! sa e gjerë!  
39 Sa e lehtë! sa e lirë!  
40 Sa e bukur! sa e vlerë!

41 Kjo' shtë mëm' e mirësisë  
42 Që bije qytetërinë,  
43 Gasthin' e vëllazërisë,  
44 Njerëzin' e miqësinë.

45 S'jemi Grekër as Bullgarë,  
46 As gjë tjetër nukë jemi,  
47 Jemi vetëm Shqipëtarë,  
48 Një kët' emër nder' e kemi.

49 Ky emr' është shumë' i mirë,  
50 Se më s'jemi të gënjyer,  
51 Nuke jemi n'errësirë,  
52 E njohmë gjen' e vjyer.

53 Perëndija na e lënte!  
54 Për jetë t'a trashëgojmë,

55 Edhe kurrë mos e dhëntë!  
56 T'a humbim a t'a harrojmë.  
  
57 Të lemë mëmënë tënë  
58 E të marimë një shtrigë!  
59 Zoti mos e pastë thënë!  
60 Pun' e keq' e shum' e ligë.  
  
61 O! sa qenë të gënjyer,  
62 Ata që vuan për botë,  
63 Turp të math kanë rrëfyer  
64 Punuanë fare kotë.  
  
65 Pa mejtoni, o të gJORë,  
66 Efialtin, Pafsaninë,  
67 Që u bënë trathëtorë,  
68 Dh' e gjënë më Perëndinë.  
  
69 Nga gjithë ç'kemi kënduar,  
70 Për të njohur vetëhenë,  
71 Kaqë gjë kemi mësuar:  
72 Të nderojmë mëmëdhenë.

73 Se njerzit gjithë vdesin,  
74 Po jeta s' mbetet e shkretë,  
75 Gjuha, Mëmëdheu mbesin,  
76 Të patundura për jetë.

77 Me zëmërë të gëzuar,  
78 Dhe me gjithë shpirt uroni!  
79 Zotërinjt' e Zotëruar!  
80 Gjithë përnjëherë thoni:

81 Rroft' e qoftë Shqipëria!  
82 Dhe kombi e gjuha jonë  
83 Lulëzofte diturija!  
84 Edhe ndihmës paçim Zonë!

85 Edhe Sulltanit të mirë,  
86 Mbretit t' math q' e kemi atë  
87 Dhe ka për neve mëshirë  
88 E përpiqet dit' e natë.

89 Zoti jet' e dit' të dhëntë  
90 Dhe qëllimet ja mbarofte!  
91 Me nder përmi front e lënte!

92 Dhe gjithënjë e gëzofte!

### PERËNDIJA

1 Ç'sheh është Zot' i vërtetë,

2 Ç'dëgjon është zër' i tija,

3 Gjithë ç'ka e s'ka në jetë

4 Është vetë Perëndija.

5 Mos shiko valët p'anë

6 Mos të gënjenjë rrëmeti,

7 Të tëra një burim kanë,

8 Gjithë ngrihen pej një deti.

9 Në det të math e të gjërë,

10 Çdo valë, që të sheh syri

11 Atje është det' i tërë,

12 Po valët mirë qyri.

13 Kur fa zësh gjënë të bërë,

14 Është' ashtu me të vërtetë,

15 Po t'a vesh re gjat' e gjërë,

16 Është' ajy bërësi vetë.

17 Dhe kush flet, edhe ç'gjë flitet,  
18 Ç'duket e s' duket në jetë,  
19 Dhe kush sheh, dh' ajo që shihet  
20 Zot' i vërtet' është vetë.

21 Se e tërë gjithësija,  
22 Që nuk' i gjëndetë fundi,  
23 Është vetë Perëndija,  
24 Për atë s'ka vënt gjëkund.

25 Është në shesht Perëndija,  
26 I verbër! s'munt t'a shohë,  
27 Ajo është gjithësija,  
28 I dituri munt t'a njohë.

29 Pe një lulezë kur shohim,  
30 Dhe të vëmë re një fletë,  
31 Me dituri, t'a njohim,  
32 Q'atje 'shtë Zot' i vërtetë.

33 Është në shesht Perëndija,  
34 Sicili do munt, t'a njohë,

35 Po s'e mbuloj e padija,  
36 Njeri tekdo munt t'a shohë.  
  
37 Kush do t'a shohë të tërë,  
38 Të shohë mirë njerinë,  
39 Vethen' e tijre të vërë,  
40 Atje gjen Perëndinë.  
  
41 Dhe Parajsi dhe Skëterra,  
42 Dhe engjëlli edhe djalli,  
43 Edhe gjithë ç'ka të tjera,  
44 Janë mbrenda tek i gjalli.  
  
45 Ajy që ka mirësinë  
46 Ka Perëndin' e të mirat,  
47 Edhe kush ka djallëzinë,  
48 Ka djallë e ligësirat.  
  
49 Më çdo anë e kërkova,  
50 Thashë, ku 'shtë Perëndija?  
51 Po më pastaj e mësova,  
52 Qenka ndaj mej' e s'e dija!

53 Kërkonja gjetkë t'a gjejë  
54 Zotn' e math e të vërtetë,  
55 Ajy qënëkej ndaj meje,  
56 E paskështa unë vetë!

57 Me fjal' e me agjërime  
58 Nuk' e gjen dot Perëndinë,  
59 As me kreshm' e me kungime,  
60 Si punojn' ata që s'dinë.

61 Trajstën' e ke plot me bukë  
62 Edhe hiqesh si i mjerë,  
63 Dhe ke zën' e thua nukë  
64 E lipën derë më derë!

65 Është ndaj teje i gjallë,  
66 Ti e kërkon nëpër gurë,  
67 Në të rrem e në përrallë  
68 Andaj nuk' e gjen dot kurrë.

69 Pa s'vdes kurrë Perëndija  
70 Po kush vdes në jetë vallë?  
71 Gjë s'vdes, sepse gjithësija

72 Është gjithënjë e gjallë.

73 Qeshë diellë, ishnja hënë,  
74 U bësh' uj' e balt' e erë,  
75 Yll e zok e dash kam qënë  
76 Pa dhe njeri shumë herë.

77 Sa det i math e i gjerë!  
78 Edhe sa mijëra valë,  
79 Si-cil' atje do të bjerë  
80 Prapë soje do të dalë.

81 Mijëra shpirtëra ngrihen,  
82 Bijen mijëra të tjera,  
83 Vjen dimëri, lulet pshihen,  
84 I nxjer prapë në shesht vera.

85 Nj' është, po ka shumë gjyrë  
86 Duket sikur s'ka të ngjarë,  
87 E sheh fytyrë fytyrë  
88 Po 'shtë i njëjt' e i pandarë.

89 Ajy është trëndafili



90 Edhe gjemb' i trëndafililit,  
91 Ajy është dhe bilbili,  
92 Ajy dhe zër' i bilbilit.

93 Mos shiko ç'robe ka veshur  
94 Është mbrënda vet' i qetë,  
95 Syr' i t'urtit e sheh çveshur  
96 Veç ati s'ka gjë ndë jetë.

97 Zoti është gjithësija  
98 Ay është gjithë ç'janë,  
99 Po kush njeh vethen' e tija  
100 S'e kërkon më tjetër anë.

101 Dhe qelqeja u-hollua  
102 Dhe vena pa u përzenë,  
103 S'ka ven' është qelqe thua  
104 A s'ka qelqe, është venë!

105 Unë ndaj teje një pikë?  
106 det i gjër' e pa anë!  
107 Të hynj brënda! më vjen frikë!  
108 Po s'hiqem dot dhe më nj' anë.

- 109 Të kisha zën' e bilbilit  
110 Gjithënjë do të këndonja  
111 Bukurin' e trëndafilit,  
112 Dhe kurrë të mos pushonja!
- 113 Po ti vetë je, o bilbil.  
114 Ti je edhe dashurija,  
115 Ti je edhe trëndafili  
116 Edhe bukuri e tija.
- 117 Ti je ç'është jet' e tërë  
118 Ti je vetë gjithësija,  
119 Ti vetë njeri je bërë  
120 More fytyrën' e tija!
- 121 Oh! det i madh, i pa-anë,  
122 Në një stamnë qysh ka hyrë?  
123 Ay q'është gjithë ç'janë!  
124 U mbloodh tok më një fytyrë?
- 125 Më çdo anë që shikova,  
126 Pashë mirë që je vetë,

- 127 Të gjeta tek të kërkova  
128 Zot' i madh e i vërtetë!
- 129 Prej trupi shpirt është bërë,  
130 Edhe shpirti trup në jetë,  
131 Është bërë një i tërë  
132 Gjithë ç'është është vetë!
- 133 Paskëtaj, o shokë, kurrë  
134 Mos kërkoni Perëndinë,  
135 Nëpër mur' e nëpër gurë,  
136 Po shihni mirë njerinë!
- 137 Zemr' e njeriut në jetë  
138 Është vënt' i Perëndisë,  
139 Është atje Zot' i vërtetë  
140 Det' i madh i gjithësisë.
- 141 Ay është gjithësija  
142 Edhe udh' e Perëndisë,  
143 Është vetëm njerëzija  
144 Q'i duhetë njerëzisë.

145 Merr' dorën e diturisë  
146 Pa ajo do të nxjerë  
147 Gjer te fron' i Perëndisë,  
148 Ndaj soje do të të shpjerë.

149 Ësht' e vërtetë kjo punë  
150 Mos qëndroni n'errësirët,  
151 Se këtë s'e gjeta unë  
152 E kanë thënë të Mirët.

### **SHPREH**

1 Kam shumë shpresë  
2 Te Perëndija,  
3 Që të mos jesë  
4 Kshu Shqipëria,  
5 Po të ndritohet  
6 Të lulëzohet.

7 Pa vjen një ditë  
8 Që të na sjellë  
9 Të madhe dritë  
10 P' ajo të pjellë:

- 11 Qytetërinë,  
12 Fatbardhësinë.
- 13 Vëllazërija  
14 Edhe bashkimi  
15 E njerëzija  
16 Është shpëtimi,  
17 Lum kush t'arrinjë!  
18 Pa do të vinjë.
- 19 Që Shqipërija  
20 Do të ndritohej,  
21 Dhe ligësija  
22 Do të mërgohet.  
23 Jak' e vërtetë!  
24 Pse rri e qetë?
- 25 Për Shqipërinë  
26 Ditët e mira  
27 Paskëtaj vinë  
28 Shkoj errësira,  
29 Lum kush të rronjë,  
30 T'a shohë zonjë!

31 Se Shqipëtar!  
32 E gjuh' e tija  
33 Venë së mbari  
34 Dhe Shqipërija,  
35 Lum kush t'a shohë  
36 Për pakë kohë.

37 Pa dituritë  
38 Dhe mbrothësija  
39 E mirësitë  
40 Dhe njerëzija,  
41 Do të burojnë  
42 Nuke mënojnë.

### **TRADHËTORËT**

1 Shokë! kemi në mest tënë  
2 Shum' armiq' e tradhëtorë!  
3 Popo! mos u qoftë thënë!  
4 Veç që s'kanë gjë në dorë!  
5 Haruanë Mëmëdhenë!

- 6 Dh' e lanë kombinë tënë!  
7 E një tjetërë na gjënë!  
8 Popc! mos u qoftë dhënë!
- 9 Lanë Zonjën' e lëvduar!  
10 E zunë një kurvë shtrigë!  
11 Të ndyr' e të mallëkuar!  
12 Të fëlliqur' e të ligë!
- 13 Lanë Mëmënë të çveshur!  
14 Dhe mundohenë për botë!  
15 Pa dhe bota duke qeshur  
16 U thotë, mundohi kotë!
- 17 Qysh u bënë Efialtë!  
18 E nuk' e njohin të mirën,  
19 Uthullën pandehin mjaltë  
20 Edhe dritë errësirën!
- 21 Buk' e Mëmëdheut i zëntë!  
22 Tradhëtorët' e pabesë,  
23 Dhe Zoti dërmën u-dhëntë,  
24 Kurrë mos paçinë pjesë!

- 25     Miqt' armiq i kanë bërë!  
26     Armiketë miq i zunë!  
27     Qysh janë fyell të tërë!  
28     Ç'është kjo e madhe punë!
- 29     Fajn' e madh kur do t'a njohin  
30     Njerëzit e mallëkuar?  
31     Dritënë pse nuk' e shohin?  
32     Apo janë të verbuar?
- 33     Janë së gjithash të marrë!  
34     Dhe të liq me të vërtetë,  
35     Mëmëdheut bëjnë varrë,  
36     Po do të bienë vetë.
- 37     Se mbretëron e vërteta,  
38     S'del kurrë gënjesht' e shkretë,  
39     T'ish ashtu, qe prishur jeta,  
40     S'kish mbetur gjë e vërtetë.
- 41     Ata turpinë fitojnë  
42     Nder' e tyre posht' e hedhin,



43 Dhe armikëtë gëzojnë  
44 E në errësirët bredhin.

45 Nuk' është kurrë harruar  
46 E mira dh' e lig' e shkretë,  
47 Të gjitha janë paguar,  
48 S'ka mbetur gjë në jetë.

49 Lerini, pa do t'a gjejnë  
50 Të vërtetën do t'a njohin,  
51 Se tani s'e dinë ç'bëjnë,  
52 Jan' të verbër' e nuk shohin.

53 O! popo, ç'turp kanë marrë!  
54 Janë bërë tradhëtorë!  
55 Dhe s'janë më Shqipëtarë  
56 Se nga kombi hoqnë dorë!

57 Me të huajnë u-bënë!  
58 Me armikn' e Shqipërisë!  
59 S'duanë gjuhënë tënë  
60 Armikëtë e Perëndisë!

61 Ndjej' o Zot se nukë dinë  
62 Se ç'bëjnë, janë mahnitur,  
63 Rrahin të prishin shtëpinë!  
64 Pun' e lig' edh' e mërzitur.

65 Të gjorët janë në gjumë!  
66 Të vërtetënë s'e dinë,  
67 Do të mundohenë shumë,  
68 Pastaj mëntë do t'u vinë.

69 Vëllazërin' e harrojnë  
70 Dhe kombin e mëmëdhenë  
71 Dhe armikëtë dëgjojnë!  
72 Edhe s'dinë se ku venë!

73 Hiqni dorë, hiqni dorë!  
74 Mblidhni mënt' e turpërohi,  
75 Mos u-bëni tradhëtorë  
76 Se pastaj do të pendohi.

## **BUKURIJA**

1 : 1 Do të këndonj Bukurinë  
1 : 2 E të lëvdonj Perëndinë,  
1 : 3 Perëndin' e bukurisë,  
1 : 4 Q'i dha shije gjithësisë!  
  
1 : 5 Perëndija bukuroshe!  
1 : 6 Ty të falem e të lutem  
1 : 7 Më vjen në gji të të futem  
1 : 8 Zonja përkëdheloshe!  
1 : 9 Që më je si mbretëreshë,  
1 : 10 Të keqen o pëllumbeshë.

## 2.

2 : 1 Zot i vërtetë!  
2 : 2 Ke mbledhur dritën,  
2 : 3 Diellin, dritën,  
2 : 4 Ndë gjithë jetë,  
2 : 5 Edh' e ke bërë  
2 : 6 Gush' e krahuar,  
2 : 7 Faqez' e ballë,  
2 : 8 Dhe pulp' e llërë,

2 : 9 Sy e qepallë,  
2 : 10 Dhe këmb' e duar!

### 3.

3 : 1 Në fytyrët tënde gjeta Bukurinë.  
3 : 2 Si ajy që gjeti në malt Perëndinë  
3 : 3 Lulezët e Majit sa janë të mira!  
3 : 4 Po përpara teje m'erdhë të pështira.

3 : 5 Kur shoh faqezët' e tua,  
3 : 6 Ç'vjeft' i mbetet trëndafilin,  
3 : 7 Zëri yt shpirt më jep mua,  
3 : 8 Nuk' i le shije bilbilit.

3 : 9 Edhe yjt' e hëna si të shëmëtuar  
3 : 10 M'u duknë, kur pashë atë syn'e shkruar.  
3 : 11 Purtek' e flarinjtë! shigjet' e ergjëntë!  
3 : 12 Zëmrënë m'a dogje, m'i përndave mëntë!

3 : 13 Do të vdisnja me shumë gas,  
3 : 14 Të paskështa pakë shpresë,  
3 : 15 Se do të thuash ti më pas,

3 : 16 Vdiq, për mua, pastë ndjesë.

#### 4.

4 : 1 Kudo është Bukurija,  
4 : 2 Në qiej, në dhë, në hënë,  
4 : 3 Në diell, në shenjë, në yje,  
4 : 4 Ndër lule, ndër drurë, ndër pyje,  
4 : 5 Çdo vënt që të ketë zënë,  
4 : 6 Atje çfaqet Perëndija,  
4 : 7 Po këtu është e tërë,  
4 : 8 Dhe ajo tin është bërë!

#### 5.

5 : 1 Pashë pjeshkëtë ndër fletë,  
5 : 2 Pa m'u-mejtua gjiri yt,  
5 : 3 Edhe më mbenë përjetë  
5 : 4 Në zëmrët, në shpirtit, në syt!  
5 : 5 Jaseminë kur e pashë,  
5 : 6 Q'ish i bardhë si dëborë,  
5 : 7 Pse më ndjek zemrën, i thashë,

5 : 8 E më ngjan më atë dorë?  
5 : 9 Dhe në mejtim të madh rashë,  
5 : 10 Më ra në det mëndja, m' u mbyt,  
5 : 11 Më la vetëm e të shkretë,  
5 : 12 Edhe të mjer' e të gjerë!

## 6.

6 : 1 Qiriri meje ka mësuar  
6 : 2 Të digjet të përvëlohet,  
6 : 3 Edhe duke përvëluar,  
6 : 4 Të qeshnjë e të gëzohet,  
6 : 5 Të bënetë zjar e flakë,  
6 : 6 Të tretët pak' e nga pakë.  
  
6 : 7 Ti e msove trëndafilë  
6 : 8 Të çelet, të lulëzohet,  
6 : 9 Të qeshnj' e të zbukurohet,  
6 : 10 T'a përvëlonjë bilbilë,  
6 : 11 E f a bënjë të pëlcasë,  
6 : 12 Një fjalë të mos i flasë,  
6 : 13 Dhe nga kjo t' i vinjë mirë,  
6 : 14 Të xbukurohet më mirë,

6 : 15 E të mos ketë mëshirë,  
6 : 16 Po t'a lerë dne pa gjumë.

## 7.

7 : 1 Bërthama jote o hurma!  
7 : 2 Më rrëfen bukur e mirë;  
7 : 3 Zembr' e buz-ëmblesë, më tha,  
7 : 4 Ësht' e fort' e p' amblësirë.  
7 : 5 Po fjalënë s'ja besova,  
7 : 6 Nuk' është' e vërtetë, thashë,  
7 : 7 Tani holl e kupëtova,  
7 : 8 Se me syt' e mi e pashë.

## 8.

8 : 1 more shtat i floringjtë!  
8 : 2 Bukurija teje buron,  
8 : 3 Edhe të rrjedh nga pëqinjtë,  
8 : 4 Gjithë jetën e xbukuron.  
  
8 : 5 Më ecën me shumë shije,  
8 : 6 Dhe si thellëza më vështron,

8 : 7 Edhe më hedh nje shkëndijë,  
8 : 8 Dhe zemrënë m' a përvëlön.  
  
8 : 9 Të keqen e këmbës sate,  
8 : 10 Të ju-bëfsha ati syri,  
8 : 11 E leshravet si tërtërë,  
8 : 12 E qepallës si gjilpërë,  
8 : 13 Që në zëmërë më hyri.  
8 : 14 Ç'pate, që më vrave, ç'pate?  
  
8 : 15 Nga qepallatë jam qarë,  
8 : 16 Po të vërtetën' e gjeta,  
8 : 17 Vetullat më paskan vrarë,  
8 : 18 Më vrau hargu, jo shigjeta.

## 9.

9 : 1 Zëmra jote në krahorrt tënt  
9 : 2 Është hekur brënda n'ergjënt;  
9 : 3 Dhe në linj' ajy krahuar,  
9 : 4 Si ndë dhë gur' i paçmuar.  
9 : 5 Dielli zënë me rezë,  
9 : 6 Vera në qelqe të zezë,



9 : 7 Shpirti brënda nër qivure,  
9 : 8 Zot' i madh nër katrë mure!

## 10.

10 : 1 Do të shtrihem  
10 : 2 Të venitem,  
10 : 3 Si kandili kur s'ka vaj,  
10 : 4 Balt' e pluhur  
10 : 5 Do të bëhem,  
10 : 6 Të më shkelnjë këmb' e saj;  
10 : 7 E të prehem  
10 : 8 Duke puthur  
10 : 9 Atë këmbë pasandaj.  
10 : 10 As më thua,  
10 : 11 Ç'ke me mua?  
10 : 12 Pse të dua paskam faj?

## 11.

11 : 1 Pse heq unë  
11 : 2 Hidhërimë,  
11 : 3 A në vdekça, ti mos qaj,

11 : 4 Vdekja ime,  
11 : 5 S'të prish punë,  
11 : 6 Haj, e zeza jetë, haj!  
11 : 7 veri! pa hiq i thua  
11 : 8 Sorkadhësë qafë-gjatë:  
11 : 9 Më ka thënë pyllë mua,  
11 : 10 S'mblidhem dot as dit' as natë!  
11 : 11 Pyetë vallë përse,  
11 : 12 Pastaj jak' e më rrëfe.  
11 : 13 Bukuroshe! sy-mëshqerë!  
11 : 14 Shikomë një herë mua,  
11 : 15 Trëndafil' i kuq me erë!  
11 : 16 E di vallë sa të dua?  
11 : 17 E mora vdekjen në sy,  
11 : 18 Do të vdes, të vdes për ty.

## 12.

12 : 1 ...Mos i hap leshratë n'erë  
12 : 2 Të m'arratiç mëndjen t'ime,  
12 : 3 Mos më shiko dhe një herë,  
12 : 4 Se m'u bë zëmra thërrime.

- 12 : 5 Si thëllëx' e bukur mos shko  
12 : 6 Mos vështro si pëllumbeshë,  
12 : 7 Shpirtinë mos m'a përvëlo,  
12 : 8 Mos u tunt si mbretëreshë.
- 12 : 9 Me qepallatë si shtijë  
12 : 10 Mos më vra mos më plagos,  
12 : 11 Me vështrim po si shkëndijë  
12 : 12 Mos më vdis e mos më sos.

### 13.

- 13 : 1 E pashë dije tek shkonte,  
13 : 2 Soje ndritte gjithë jeta,  
13 : 3 Pa hoth syt' e më shikonte,  
13 : 4 Duke kthyer si shigjeta!  
13 : 5 Posa pashë Bukurinë,  
13 : 6 Zemrën' e varfrë m'a piku,  
13 : 7 Ndjeva në të dashurinë,  
13 : 8 Që më erdh, dhe më s'më iku,  
13 : 9 Pse s'ka fjalë të dëftenjë  
13 : 10 Dashurin' e Bukurinë,  
13 : 11 Nuk' e them dot atë ndjenjë,

13 : 12 Nuk' e them dot Perëndinë!

13 : 13 Mos u mundo kot,

13 : 14 Nukë thuhet dot.

#### 14.

14 : 1 M' iku me vrap djalërija

14 : 2 E më la mbi dhe të shkretë,

14 : 3 Më erdh shtriga pleqërija

14 : 4 Fshehtazi, si qen' i qetë.

14 : 5 popo! ç'më gjet, o shokë,

14 : 6 Do të qanj me thes më kokë,

14 : 7 ditët e djalërisë.

14 : 8 Që kishit shumë gëzime

14 : 9 Ratë në det t'arratisë,

14 : 10 Më latë në hidhërimë!

14 : 11 Tani jetënë ç'e dua,

14 : 12 Më s'është e shkreta për mua.

14 : 13 Ti o bukuroshja ime!

14 : 14 Të ritë m'a paç për jetë,

14 : 15 Kurrë mos pafsh hidhërimë!

14 : 16 Të dashtë Zot' i vërtetë!

14 : 17 Syri yt mos u-venittë.

## 15.

- 15 : 1 Vera vate, shkoj,  
15 : 2 Bilbili pushoj,  
15 : 3 Lulet u-thanë!  
15 : 4 Dimëri u-qas,  
15 : 5 Dëborë vjen pas,  
15 : 6 Fletëtë rënë.  
15 : 7 Gjësendi më s'mbet  
15 : 8 Thua për mi dhet,  
15 : 9 Shpestë pushuan!  
15 : 10 Zëmra ime zjen,  
15 : 11 E ty më s'të gjen  
15 : 12 Pa heq e vuan.

## 16.

- 16 : 1 Erdh e na gjet  
16 : 2 Vera mi dhet,  
  
16 : 3 Dhe këtë herë  
16 : 4 Për shumë vjet

16 : 5 E me shëndet,  
16 : 6 Na gieç, o verë!  
16 : 7 Sa më pëlqen,  
16 : 8 E ç'më dëfren  
  
16 : 9 Luleja mua!  
16 : 10 Ç'mirë më vjen  
16 : 11 Se shembëllën  
  
16 : 12 Faqet e tua.  
16 : 13 Del të të shoh,  
16 : 14 Oh! oh! oh! oh!  
  
16 : 15 sy mëshqerë  
16 : 16 Dua t'a ngroh,  
16 : 17 Se po m'u ftoh  
  
16 : 18 Zembr' e mjerë.  
16 : 19 Syri m'u vesh,  
16 : 20 Po del në shesh,  
  
16 : 21 Malli m'u shtua,

16 : 22 Shih, mos më lesh!

16 : 23 Popo! kur qesh,

16 : 24 Ah, sa të dua!

## **VAREFERIJA**

### **1.**

1 : 1 Ju të pasur, kur rrini

1 : 2 Rreth zjarit me gëzime

1 : 3 Qeshni, hani e pini,

1 : 4 Xbaviti me dëfrime.

1 : 5 Këceni e këndoni,

1 : 6 Dhe çeli e gëzohi,

1 : 7 Bëni gaxhi e loni

1 : 8 Edhe prëhi e ngrohi.

1 : 9 Ju vjen së largu afshi,

1 : 10 Ndë sallonet të gjerë,

1 : 11 Shtruarë pej mëndafshi

1 : 12 Mbushur me gjë të vlerë.

- 1 : 13 Nga ari, nga ergjëndi,  
1 : 14 Nga floriri, nga drita  
1 : 15 Llapëtin gjithë vëndi,  
1 : 16 Tfaqet natënë dita.
- 1 : 17 Zonjat bukuroshe  
1 : 18 Veshur, rrobat' e arta,  
1 : 19 Vashatë vogëloshe,  
1 : 20 Të bardha posi karta.
- 1 : 21 Djemthit e përkëdhelur  
1 : 22 Të lartë e të ndruar  
1 : 23 Me zëmërë të çelur,  
1 : 24 Me buzë të gëzuar.
- 1 : 25 Vinë rreth e kërcejnë,  
1 : 26 Dhe qeshin e këndojnë,  
1 : 27 Lozinë e dëfrejnë,  
1 : 28 Kohën me gaz e shkojnë.
- 1 : 29 Dhe juve duke parë  
1 : 30 Me sy fatbardhësinë,



- 1 : 31 S'ju vjen fare të qarë  
1 : 32 Vallë për varfërinë?  
  
1 : 33 E dini, q'është jashtë  
1 : 34 Një plak' e dobëtuat:  
1 : 35 E përgynjyr, e lashtë,  
1 : 36 E mjer' ë dëshëruar,  
  
1 : 37 E fishkur' edh' e thatë,  
1 : 38 E thinjur e kërcure,  
1 : 39 E urët dit' e natë,  
1 : 40 Dergjetë nër qivure!  
  
1 : 41 Një plak' q'i vdiq fëmija,  
1 : 42 Edhe mbet e helmuar,  
1 : 43 Se ju shkretua shtëpija,  
1 : 44 Mbet si kandil' i shuar!  
  
1 : 45 Një foshnj' e varfëruar,  
1 : 46 Pa mëmëz' e pa atë,  
1 : 47 E gjor' e dobëtuat!  
1 : 48 E ligur e e thatë!

1 : 49 Gjithë këta të mjerë  
1 : 50 Në të këqija rrojnë,  
1 : 51 Vin' e lipin më derë,  
1 : 52 Një kafshitë kërkojnë!

1 : 53 E kur vjen të kërkonjë,  
1 : 54 Brengën s'munt t'a rrëfenjë,  
1 : 55 E rreh të na dëfrenjë!

1 : 56 Sa 'shtë turp për njerinë,  
1 : 57 Ku shkojm' e s'kthejmë synë!  
1 : 58 S'dëgjojmë Perëndinë?  
1 : 59 S'është vëllathi ynë?

1 : 60 Oh! epni, ju që kini,  
1 : 61 Kush i ndih varfërisë,  
1 : 62 Ay q'ep, po e dini,  
1 : 63 Q'i huan Perëndisë.

1 : 64 T'apim, se vjen një ditë  
1 : 65 Q'e lemë këtë jetë,  
1 : 66 Dhe gjen' e begatitë,  
1 : 67 Vemi në të vërtetë,

- 1 : 68 Përpara Perëndisë,  
1 : 69 Që do të na gjykonjë,  
1 : 70 Urat' e varfërisë  
1 : 71 Arrin të na shpëtonjë.
- 1 : 72 Ajo or' e borinjte,  
1 : 73 Që ligjëron e bije,  
1 : 74 Rreth t'i mplaknjë të rinjtë,  
1 : 75 Buzë varrit na shpije!
- 1 : 76 Epni t'u falnjë Zoti  
1 : 77 Juve gjithë të mirat,  
1 : 78 E të mos muntnjë moti  
1 : 79 T'ju sjellë të pahirat.
- 1 : 80 Mba unazat në dorë  
1 : 81 Pa një farë nevoje!  
1 : 82 Zonjë! shumë të gjorë  
1 : 83 Vdesën për bukë ngojë!
- 1 : 84 Ep t'apë Perëndija  
1 : 85 Të gjitha mirësitë,

- 1 : 86 Të të kenë fëmija  
1 : 87 Shëndet e jet' e ditë.  
  
1 : 88 Zot i madh, i vërtetë!  
1 : 89 E gjithë ju të Mirët!  
1 : 90 Mos e lini për jetë  
1 : 91 Njerinë n'errësirët.

## 2.

- 2 : 1 Sa jemi Shqipëtarë,  
2 : 2 Kemi gjithë një besë,  
2 : 3 Jemi gjithë një farë,  
2 : 4 Dhe rrojmë me një shpresë,  
2 : 5 S'jemi kurrë të ndarë.  
  
2 : 6 Bes' është Perëndija  
2 : 7 Për gjithë Shqipëtarët.  
2 : 8 Edhe vëllazërija,  
2 : 9 Urtësija, të mbarët,  
2 : 10 Fë është njerëzija.  
  
2 : 11 Më çdo vënt që të jemi,

- 2 : 12 Mëmëdhen' e kujtojmë,  
2 : 13 Edhe kudo të vemi,  
2 : 14 Kombinë s' e harrojmë,  
2 : 15 Vëllazërin' e kemi.
- 2 : 16 Si do që të na ndajnë,  
2 : 17 Ne jemi të bashkuar,  
2 : 18 S' mundinë të na çajnë,  
2 : 19 Zoti na ka uruar,  
2 : 20 Pa në kurt dot s' na mbajnë.
- 2 : 21 Në ka pasur në jetë,  
2 : 22 Trima shumë të ndjerë,  
2 : 23 E burra të vërtetë,  
2 : 24 Kombi yn' i ka nxjerë,  
2 : 25 At' e di Zoti vetë.